



Under the auspices of
the Secretary General of
the Council of Europe,
Mr Thorbjørn Jagland



Manifesti Rural Evropian

Adoptuar në Përmbylljen e Parlamentit të Dytë Rural Evropian, mbajtur më datat 4 – 6 Nëntor 2015 në Scharding, Austri, e ku morën pjesë 240 delegatë nga 40 vende evropiane, si dhe përditësuar në Parlamentin e Tretë Rural Evropian mbajtur në datat 18 - 21 Tetor 2017 në Venhorst, Holandë, ku morën pjesë 250 persona nga 40 vende evropiane.

1. Ne, përfaqësuesit e shumë popujve dhe organizatave me qendër në zonat rurale në të gjithë kontinentin e Evropës, kemi adoptuar këtë Manifest Rural Evropian si një deklaratë e aspiratave, angazhimeve dhe kërkesave të popullit rural, bazuar në mbledhjet në shumë vende gjatë fushatave të Parlamentit Rural Evropian në periudhën 2015-2017.

2. Larmia e zonave rurale

Thellësisht vlerësojmë si unitetin evropian, ashtu edhe larminë e zonave dhe popujve të saj, të cilat vijnë nga gjeomorfologjia e larmishme, klima dhe biodiversiteti i tokës dhe detit dhe nga historia e gjatë e aktivitetit njerëzor në të gjithë kontinentin. Ne e shohim këtë unitet dhe këtë larmi, sikundër shprehur në kulturën njerëzore dhe burimet natyrore, si një aset të jashtëzakonshëm për mirëqenien e ardhshme të të gjithë popujve në Evropë.

3. Vlera të përbashkëta

Ne vlerësojmë vlerat e përbashkëta të cilat lidhin popujt e Evropës – demokracinë, barazinë, rregullin e ligjit, njohjen e të drejtave njerëzore, shpirtin e bashkëpunimit. Këto vlera aktualisht po sfidohen nga forcat politike në disa pjesë të Evropës dhe nga sistemet globale. Ne jemi të angazhuar që të mbështesim këto vlera, në mënyrë që të krijojmë një Evropë të paqtë dhe shoqërisht të drejtë.

4. Cilësia e jetës

Ata të cilët jetojnë në Evropën rurale e vlerësojnë jashtëzakonisht cilësinë e jetës që mund të ofrohet nga zonat rurale, fermat, fshatrat dhe qytezat e vogla, zonat bregdetare dhe ishujt, malet dhe pyjet me kulturat e tyre lokale, kafshët e egra, peizazhet, mjedisin e shëndetshëm, trashëgiminë kulturore dhe fuqinë shoqërore si dhe mbështetjen e ndërsjellë që gjendet në komunitetet rurale.

5. Shqetësim mbi kushtet rurale

Megjithatë, ne jemi tejet të shqetësuar që shumë rajone janë ndikuar nga ngushtësia e ekonomive rurale, mungesa e mundësive për punë të kënaqshme dhe të paguar në mënyrë të drejtë, humbja e popullsisë ndërkohë që të rinjtë largohen, pabarazia demografike pasuese,



Under the auspices of
the Secretary General of
the Council of Europe,
Mr Thorbjørn Jagland

rënia në shërbime, varfëria dhe përjashtimi social midis personave të paprivilegjuar apo minoritetet etnike si dhe degradimi mjedisor.

6. Nevoja për veprim

Ne besojmë me bindje që këto sfida duhet të adresohen, për të mirën e jo vetëm komuniteteve rurale, por gjithashtu për të gjithë popullsinë e Evropës. Të gjithë ne varem nga ushqimi, lënda drusore, fibra, energjia, uji dhe mineralet e prodhuara në zonat rurale. Fermerët, sipërmarrjet dhe aktorë të tjerë lokalë krijojnë një pasuri të përbashkët për Evropën. Zonat rurale kontribuojnë në shkallë të gjerë në përmirësimin e ndryshimit të klimës, kohën e lirë, shëndetin publik dhe mirëqenien shoqërore, ekonomike dhe shpirtërore. Fshati meriton respektin e qytetarëve urbanë.

7. Të drejta

Ne pohojmë të drejtën e zonave dhe komuniteteve rurale për njohje të plotë nga të gjithë popujt dhe institucionet e Evropës, për një cilësi jete dhe standard jetese të barabartë me popullsinë urbane dhe në pjesëmarrje të plotë në proceset politike.

Ne i kërkojmë qeverive të të gjitha niveleve të mbështesin këtë të drejtë. Në të gjitha aspektet e politikave dhe veprimeve të lidhura me komunitetet rurale, njerëzve u duhen siguruar të drejta të barabarta pavarësisht moshës, gjinisë, seksualitetit, aftësisë apo etnisë.

8. Vizioni

Vizioni ynë për të ardhmen e Evropës rurale është për komunitete rurale të gjalla, përfshirëse dhe të qëndrueshme, mbështetur nga një ekonomi rurale e larmishme dhe nga një kujdestari efikase e trashëgimisë mjedisore dhe kulturore me cilësi të lartë. **Ne besojmë** që komunitetet rurale, të modeluar mbi këtë vizion, mund të jenë kontribuues afatgjatë ndaj një Evrope të zhvilluar, paqësore, të drejtë dhe të barabartë, dhe ndaj një shoqërie globale të qëndrueshme. Ambicia jonë është që të inkurajojmë veprimin në nivelin e fshatit në të gjithë Evropën rurale, duke krijuar me kalimin e kohës një lëvizje pan-evropiane të komunitetit rural apo fshatit. **Ne jemi për** një fuqizim radikal të demokracisë rurale jo vetëm në aspektin e popullsisë, por gjithashtu në përmasën e territorit dhe sasinë e burimeve që komunitetet rurale menaxhojnë.

9. Partneriteti

Ndjekja e vizionit tonë kërkon në çdo vend një partneritet të rifreskuar dhe të drejtë midis popujve dhe qeverive. Ne, popullsia dhe organizatat rurale, e dimë që kemi një përgjegjësi për të udhëhequr dhe vepruar drejt mirëqenies sonë kolektive. **Por gjithashtu, në mënyrë të drejtë, kërkojmë** që qeveritë e të gjitha niveleve, përfshirë institucionet evropiane, të punojnë për ta bërë këtë partneritet vendimtar, efikas.

10. Kuadri politik

Ne ngrohtësisht mbështesin parimet e përcaktuara në Deklaratën Cork 2.0, e muajit shtator 2016, përfshirë thirrjen ndaj politikëbërësve të Bashkimit Evropian për të:

- “Përmirësuar ndërgjegjësimin publik mbi potencialin e zonave dhe burimeve rurale për të ndikuar në një gamë të gjerë të sfidave dhe mundësive ekonomike, shoqërore dhe mjedisore nga të cilat përfitojnë të gjithë qytetarët evropianë;



Under the auspices of
the Secretary General of
the Council of Europe,
Mr Thorbjørn Jagland

- “Investuar në identitetin e komuniteteve rurale, potencialin për rritje rurale dhe për t’i bërë zonat rurale tërheqëse si vend jetese dhe pune për njerëzit në të gjitha fazat e ndryshme të jetëve të tyre;
- “Ndërtuar mbi këtë vrull dhe zhvilluar më tej politikat bujqësore dhe rurale drejt një qasjeje të orientuar në rezultate, të thjeshtë dhe fleksibël, bazuar në partneritet dhe duke pasqyruar objektivat e Bashkimit si dhe nevojat dhe aspiratat e shprehura;
- “Rishikuar në mënyrë sistematike politikat e tjera makro dhe sektoriale nëpërmjet lenteve rurale, duke konsideruar ndikimet dhe implikimet e mundshme dhe aktuale mbi punët rurale dhe perspektivën e rritjes dhe zhvillimit, mirëqenien shoqëror dhe cilësinë mjedisore të zonave dhe komuniteteve rurale.”;

Sipas mendimit tonë, kjo thirrje shkon në mënyrë të barabartë për të gjithë politikëbërësit jashtë Komunitetit Evropian.

11. Përmbysja e spirales së rënies

Shumë rajone janë ndikuar nga një “spirale rënieje” në gjallërinë e komuniteteve rurale. Humbja e popullsisë (veçanërisht e të rinjve) çon drejt një gjallërie të reduktuar të shërbimeve rurale dhe ekonomive lokale të dobësuar, gjë e cila nxit më shumë humbje të popullsisë. Ne bëjmë thirrje për përpjekje të përqendruara nga ana e palëve rurale të interesuara, të gjitha agjencive përkatëse dhe qeverive, që të ‘përmbysin spiralen’ duke promovuar vlerësimin e dhe krenarinë në mënyrën rurale të jetesës, duke forcuar shërbimet rurale, nxitjen e larmisë në ekonomitë rurale, dhe duke mundësuar qëndrimin apo rikthimin e të rinjve në zonat rurale.

12. Rinia

Shumë të rinj janë të gatshëm të qëndrojnë apo të transferohen në zonat rurale dhe të marrin përsipër përgjegjësi si fermerë, sipërmarrës apo qytetarë ruralë për mirëqenien e ardhshme të ekonomive dhe komuniteteve rurale. Të rinjtë kanë nevojë për punësim konkurrues dhe të qëndrueshëm, sisteme arsimimi të mirë-syruara, vullnetarizëm dhe trajnim profesional, nxënie në profesione bazuar në nevojat lokale, të drejtë për të pasur tokë, strehim dhe kredi, aktivitete shoqërore dhe kulturore të përshtatshme për të rinjtë, si dhe këshilltarë dhe mbështetje specifike ndaj fermerëve dhe sipërmarrësve të rinj. I njohim të rinjtë si faktorë kyç në zhvillimin rural dhe mirëpresim ngrohtësisht kontributin që mund të japin ndaj programit të mbështetjes dhe veprimit bazuar në këtë Manifest. **I bëjmë thirrje** qeverive dhe shoqërive civile të njohin dhe përmbushin nevojat e rinisë dhe t’i mundësojnë rinisë pjesëmarrje në mënyrë aktive në proceset politike dhe veprimet rurale.

13. Refugjatët dhe imigrantët ekonomikë

Mbërritja në Evropë e refugjatëve dhe njerëzve të tjerë të dëshpëruar nga zonat në konflikt dhe katastrofa, dhe të personave nga vendet e varfra që kërkojnë punë, po provokon mendime dhe veprime brenda rrjeteve tona. Ndërkohë që nxisim qeveritë dhe agjencitë e tjera të punojnë me urgjencë për të zgjidhur shkaqet themelore të krizave, **bëjmë thirrje** për një përgjigje të ngrohtë, bazuar në solidaritetin midis popujve. Ne besojmë që për shumë zona rurale, dhe veçanërisht ato me popullsi në rënie, kjo ofron një mundësi për të integruar refugjatët dhe të ardhurit e tjerë. Organizatat qeveritare dhe të shoqërisë civile janë të mirë-ndodhura për të drejtuar përpjekje të tilla integrimi.



Under the auspices of
the Secretary General of
the Council of Europe,
Mr Thorbjørn Jagland

14. Varfëria dhe përjashtimi

E njohim progresin që është bërë në luftën kundër varfërisë dhe përjashtimit social në Evropë. Por miliona njerëz janë ende të ndikuar nga varfëria dhe përjashtimi social të llojeve të ndryshme. Kohëzoni social dhe territorial janë pjesë integrale për vizionin tonë të Evropës. **Bëjmë thirrje** për një përpjekje të qëndrueshme për të promovuar përfshirjen dhe pjesëmarrjen e plotë në shoqëri. Një shqetësim i veçantë janë nevojat e komuniteteve rromë në shumë vende evropiane, të cilët janë ndër njerëzit më të varfër dhe më të përjashtuar të personave ruralë të Evropës. Ata duhet të njihen si persona që kanë të drejta të barabarta për punë dhe arsimim për fëmijët e tyre.

15. LEADER dhe ZHLUK

Ne mbështesim me bindje një qasje territoriale të integruar dhe bazuar në partneritet ndaj zhvillimit rural, ndjekur me një frymë poshtë-lart dhe bazuar në vend. Dëshirojmë të shohim një aplikim të gjerë të parimit LEADER dhe zgjatjes së tij në Zhvillimin Lokal të Udhëhequr nga Komuniteti (ZHLUK), të dyja brenda dhe përtej BE-së. Jemi tejet të shqetësuar nga mungesa aktuale, në shumë vende, e një procesi vërtet të integruar të zhvillimit rajonal dhe rural. Ne nxisim institucionet dhe qeveritë në BE që të tregojnë besim në Grupet e Veprimit Lokalë, për të zgjeruar financimin e tyre, për të përshtatur rregullat dhe procedurat e tyre ndaj nevojave të komuniteteve rurale, si dhe për të siguruar një qasje vërtet të integruar ndaj zhvillimit lokal dhe përdorimit të fondeve të shumëfishta. Nxisim të gjithë sektorët në Ballkanin Perëndimor dhe vendet e Detit të Zi që të shtrojnë rrugën e partneritetit midis sektorëve për përdorimin e LEADER dhe ZHLUK.

16. Shërbimet dhe infrastruktura rurale

Shërbime rurale bazë, të tilla si dyqanet, shërbimet postare, shkollat, qendra shëndetësore dhe transporti si edhe infrastruktura sociale, janë themele jetësore për cilësinë e jetës në zonat rurale. Infrastruktura fizike e përshtatshme – furnizimi me ujë, sistemet e kanalizimeve dhe energjia elektrike, furnizimi me energji, sistemet e transportit – gjithashtu janë jetësorë. Por në shumë rajone rurale, shërbimet rurale janë tashmë të dobëta ose po humbasin dhe infrastruktura është e papërshtatshme, gjë e cila kontribuon në një rreth vicioz të rënies. U bëjmë thirrje qeverive dhe ofruesve të shërbimeve që të njohin të drejtën e popujve ruralë për një infrastrukturë të përshtatshme dhe qasje të arsyeshme ndaj të gjitha shërbimeve bazë, dhe t'u mundësojnë komuniteteve rurale marrjen e vendimeve dhe ndërmarrjen e veprimeve për të siguruar shërbime dhe infrastrukturë të përshtatshme për nevojat e tyre.

17. Komunikimi “broadband” dhe i lëvizshëm

Qasja ndaj telekomunikimeve të një kapaciteti të lartë po bëhet thelbësor për jetën shoqërore, kulturore dhe ekonomike të të gjithë evropianëve dhe për sigurimin e shërbimeve jetësore. Për shkak të distancës së tyre dhe popullsisë së shpërndarë, zonat rurale kanë nevojë të veçanta për telekomunikim efikas. Megjithatë, shumë zona rurale, veçanërisht në Evropën qendrore dhe lindore dhe në rajonet periferike të BE-së, ende janë në disavantazh të thellë për shkak të dobësisë në sistemet e komunikimit. **U bëjmë thirrje** qeverive, financuesve shumë-kombesh dhe ofruesve të shërbimit të telekomunikimit, të punojnë urgjentisht në drejtim të sigurimit të shërbimit broadband dhe të lëvizshëm të një shpejtësie të lartë për të gjithë popullsinë rurale, përfshirë zonat më të largëta, me tarifa të harmonizuara në të gjithë Evropën. Komunitetet



Under the auspices of
the Secretary General of
the Council of Europe,
Mr Thorbjørn Jagland

rurale duhet të mundësohen që të ndërmarrin vetë veprime për të siguruar këtë shërbim. Të dhëna të hapura mbi aspekte të ndryshme të zonave reale duhet të jenë gjerësisht të disponueshme, si një mjet gjithmonë e më i fuqishëm për të ndihmuar sipërmarrjet rurale dhe palët e tjera të interesuara.

18. Ekonomitë rurale dhe nën-rajonale

Rajonet rurale të Evropës përfshijnë mijëra nga ekonomitë lokale dhe nën-rajonale, të pasura në sipërmarrje mikro, të vogla dhe mesatare, të cilat formojnë gjakun e komuniteteve dhe kontribuojnë gjerësisht në ekonomitë më të gjera të kombeve evropiane. **Ne pohojmë** rëndësinë e madhe të rritjes së gjallërisë dhe qëndrueshmërisë së këtyre ekonomive lokale dhe nën-rajonale në të gjithë Evropën rurale. Mjetet për të bërë këtë do të ndryshojnë nga vendi në vend, por mund të mbështesin iniciativa në shumë sektorë të ndryshëm – bujqësia, pylltaria, peshkimi, prodhimi i energjisë, industria e prodhimit duke përfshirë sipërmarrje të vlerës së shtuar, zinxhirët e furnizimit, turizmi dhe industritë e shërbimeve, si edhe bizneset e bazuar në teknologjinë e informimit. Ka një shtrirje të gjerë të sipërmarrjeve shoqërore. E një rëndësie të veçantë është sigurimi i këshillimit të gjithanshëm, mbështetjen e biznesit dhe shërbimet e kreditimit, plus arsimimi dhe trajnimi profesional, të përshtatur në mënyrën e duhur ndaj mundësive të punës ekzistuese dhe të mundshme.

19. Fermtat e vogla dhe familjare

Njohim kontributin madhor që fermtat komerciale japin ndaj ekonomisë evropiane. Megjithatë, jemi tejet të shqetësuar për mirëqenien e miliona fermave të vogla dhe familjare në BE dhe në Evropën Juglindore dhe në Rajonin e Detit të Zi, veçanërisht në zonat e largëta, malet dhe ishujt. Këto ferma i sigurojnë jetesën miliona familjeve, furnizojnë me ushqim tregjet lokale, krijojnë popullsinë kryesore të mijëra komuniteteve, dhe mbështesin mënyrat tradicionale të jetës në të cilat shëndeti i tokës, peizazheve, ekosistemit dhe trashëgimisë kulturore varen. Ato mund të mbajnë qëndrueshmëri duke formuar kooperativa dhe sipërmarrje bujqësore shoqërore, duke i shtuar vlerë në mënyrë kolektive produkteve të tyre, shtuar larminë e të ardhurave të fermës së tyre dhe ekonomive lokale, dhe gradualisht duke formuar njësi toke më të mëdha. Ne nxisim qeveritë, donatorët, organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetet rurale të njohin dhe mbështesin fermtat e vogla dhe bujqësinë familjare si një model i qëndrueshëm dhe i respektuar evropian; dhe të mbështesin kalimin e gjeneratave dhe futjen e fermerëve të rinj.

20. Qytezat e vogla

Qytezat e vogla, të cilat numërojnë me mijëra në Evropë, kanë një rëndësi thelbësore si qendra shoqërore, ekonomike dhe kulturore për komunitetet rurale. Ato janë qendra për tregtinë, shërbimet publike dhe sociale, shkollat e mesme dhe shërbimin shëndetësor; ofrojnë mundësi të mëdha për turizmin; dhe në mënyrë kolektive japin një kontribut madhor ndaj ekonomive rajonale dhe kombëtare. Megjithatë, nuk njihen si një objekt madhor i politikave dhe programeve kombëtare apo evropiane, shpesh duke u parë as si rurale, dhe as si urbane. **Ne mbështesim** një politikë kryesore të Bashkimit Evropian të fokusuar në qytezat e vogla, duke njohur të gjitha kontributet e rëndësishme që ato bëjnë në strukturat sociale dhe ekonomike të rajoneve rurale dhe vitalitetit të tyre; dhe për fokus më të madh në nevojat e qytezave të vogla në politikat kombëtare.



Under the auspices of
the Secretary General of
the Council of Europe,
Mr Thorbjørn Jagland

Ne mirëpresim interesin në rritje si në zonat rurale ashtu edhe ato urbane, në zhvillimin lokal të udhëhequr nga komuniteti. **Bëjmë thirrje** për një bashkëpunim në rritje midis komuniteteve, organizatave dhe autoriteteve në zonat rurale në mënyrë që të arrihet përfitimi i plotë i lidhjeve sociale, kulturore dhe ekonomike që këto bashkëpunime mund të sjellin; dhe për një shkëmbim energjik të ideve dhe praktikave të mira midis atyre të përfshirë në zonat rurale dhe urbane.

21. Ndryshimi i klimës dhe burimet natyrore

Vëmë në dukje me shqetësim të madh evidencën në rritje të një ndikimi serioz të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë në ndryshimin e klimës. Kundër këtij sfondi, **ne mbështesim** angazhimet shumë-kombesh të bërë në Konferencën e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet në Klimë, dhe **nxisim** të gjitha qeveritë evropiane edhe të gjitha palët e interesuara të veprojnë me urgjencë në bazën e atyre angazhimeve. **Ne mbrojmë** rolin madhor që zonat rurale të Evropës mund të luajnë në luftimin e ndryshimeve të klimës dhe mbështetjen e burimeve mjedisore; dhe gjithashtu njohim nevojën për të ndihmuar zonat rurale për t'u përshtatur me ndryshimet e klimës.

Mbi 40 përqind e sipërfaqes së tokës së Evropës është në pyje, e cila mund të kapë dhe sekuestrojë karbonin dhe e cila kontribuon pasivisht në burimet e rinovueshme të materialeve të para dhe energjisë. Zonat rurale dhe bregdetare janë të mirë-vendosura për të përmbushur kërkesën në rritje për energji të rinovueshme nga burimet e erës, ujit, baticave e zbatave, gjeotermale dhe pyjore, në mënyra që respektojnë natyrën e paprekur dhe mjedisin e tokës dhe ujit, dhe të cilat sjellin përfitime të drejtpërdrejta dhe punësim për komunitetet rurale. **Bëjmë thirrje për** përdorim në rritje të qasjeve të pylltarisë bujqësore, ekologjisë bujqësore dhe bio-ekonomisë. **Gjithashtu nxisim** që kushtet e krijuara nga ndryshimi i klimës të merren parasysh në përkufizimin e rajoneve në disavantazh kur vlerësohet alokimi i mbështetjes financiare.

22. Ballkani Perëndimor dhe Evropa Juglindore

Komunitetet dhe ekonomitë rurale në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Evropës Juglindore janë thellësisht të ndikuara nga paqëndrueshmëria politike në rajon. Vonesat në procesin e pranimit në Bashkimin Evropian kanë ngadalësuar procesin e reformës politike. Zhvillimi rural është parë nga qeveritë si një prioritet i ulët. Ne nxisim BE-në të përshpejtojë procesin e pranimit në këtë rajon, duke përfshirë një mbështetje më efektive ndaj proceseve të zhvillimit rural.

23. Udhëheqja në zhvillimin rural

Pranojmë rolin e rëndësishëm të udhëheqjes në të gjitha nivelet dhe midis niveleve. Njohim që përgjegjësia kryesore për identifikimin e nevojave dhe dhënien e zgjidhjeve është e jona, aktorëve ruralë. Megjithatë, udhëheqja në zhvillimin rural përfshin veprim kolektiv nga nivelet lokale, rajonale, kombëtare dhe evropiane dhe karakterizohet nga angazhimi, komunikimi, bashkëpunimi dhe krijimi i besimit. **I bëjmë thirrje** shoqërisë civile, qeverive dhe sektorit privat që të punojnë në partneritet për të ofruar ndërtim të kapaciteteve, burime dhe mbështetje për të krijuar një mjedis i cili inkurajon udhëheqjen novatore, të qëndrueshme dhe të përgjegjshme, duke frymëzuar dhe angazhuar udhëheqësit e ardhshëm.



Under the auspices of
the Secretary General of
the Council of Europe,
Mr Thorbjørn Jagland

24. Rrjetet e Shoqërisë Civile

Rrjetet evropiane dhe ndërkombëtare të cilët kanë udhëhequr këtë fushatë të Parlamentit Rural Evropian i kanë rrënjët në veprimet lokale dhe demokracinë e pjesëmarrjes. Anëtarësimi i tyre përfshin mijëra grupe veprimi në nivel fshati, shoqata lokale, kooperativa dhe struktura të tjera të cilat menaxhojnë shërbimet thelbësore dhe promovojnë bashkëpunimin midis aktorëve ruralë. Ato kanë një rol në rritje në veprimin praktik në zonat rurale, përballë ndryshimeve në profilin e aktorëve të sektorit publik. **I bëjmë thirrje** qeverive dhe institucioneve evropiane që të njohin kontributin jetësor të OJQ-ve dhe rrjeteve të tyre, të respektojnë pavarësinë e tyre dhe të mbështesin aktivitetet e tyre.

25. Partneriteti midis shoqërisë civile dhe qeverive

Ne besojmë që zhvillimi rural efikas kërkon një partneritet mendje hapur dhe novator midis njerëzve dhe qeverive, krah për krah, si të barabartë. **I bëjmë thirrje** palëve të interesuara rurale që të punojnë në mënyrë pozitive me qeveritë; dhe u bëjmë thirrje qeverive, institucioneve ndërkombëtare dhe agjencive përkatëse për të krijuar sisteme kuptimplotë këshillimi dhe vendimmarrjeje bashkëpunuese, në mënyrë që të mundësohet pjesëmarrja e palëve të interesuara rurale në formimin dhe implementimin e politikave dhe për të shtruar një themel të fortë për një partneritet frutdhënës midis palëve të interesuara rurale dhe qeverive në të gjitha nivelet.

26. Një klimë mbështetëse

U bëjmë thirrje qeverive që të veprojnë me një frymë partneriteti besimplotë dhe mendje hapur me të gjitha komunitetet rurale, duke njohur të drejtën e tyre për vetë-përcaktim; dhe të sigurojnë një klimë mbështetëse ligji, rregulloreje, administrimi dhe finance. Kjo klimë mbështetëse duhet të përfshijë një angazhim të plotë ndaj demokracisë dhe rregullit të ligjit; koherencës midis aspekteve të ndryshme dhe niveleve gjeografike të politikave në të gjithë fushën e veprimit qeveritar lidhur me zonat rurale; përkrahëse ndaj zonave rurale për të gjitha programet dhe politikat e lidhura me to; projektim i thjeshtëzuar dhe përdorim i ndjeshëm dhe fleksibël i sistemeve rregullatore, fiskale dhe financiare për të inkurajuar iniciativat nga individët, ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, sipërmarrjet sociale, kooperativat e të tjera; dhe respekt për të drejtat e komuniteteve rurale në krijimin e ligjeve dhe traktateve ndërkombëtare.

27. Arsimimi

Në një botë që ndryshon, njerëzit kudo kanë nevojë në mënyrë të vazhdueshme të përmirësojnë aftësinë e tyre për t'u përshtatur dhe përtërirë në aktivitetin shoqëror dhe ekonomik. Për këtë arsye, arsimimi dhe mësimi përgjatë gjithë jetës – duke filluar në fëmijërinë e hershme – kanë një vend kyç në mundësimin e lulëzimit të komuniteteve rurale, me bashkëpunimin dhe lidhjet në rrjet të nevojshme, dhe të marrin pjesë plotësisht në proceset zhvilluese.

Kanë rëndësi të veçantë në mundësimin e të rinjve që të kuptojnë mundësitë për një jetë të pasur dhe të qëndrueshme në fshat, për të arritur dhe rinovuar në mënyrë konstante aftësitë të cilat nevojiten dhe për të marrë pjesë si qytetarë. **Ne nxisim** autoritetet e arsimit që të sigurojnë qasje efektive për komunitetet rurale ndaj shërbimeve të arsimit, duke përfshirë

shkollën fillore në nivel fshati, arsimimin e mesëm dhe për të rritur, studimin në distancë, vullnetarizmin dhe trajnimin profesional përshtatur ndaj realiteteve të jetës rurale.

28. Shkëmbimet ndërkombëtare

Ne besojmë që puna për të arritur zhvillim rural të qëndrueshëm në të gjithë Evropën mund të ndihmohet dhe përshejtohet tejte nga shkëmbimi i praktikave të mira midis palëve të interesuara rurale dhe qeverive në të gjitha vendet evropiane dhe më gjerë. Lindja dhe Perëndimi mund të kontribuojnë në mënyrë të barabartë dhe përfitojnë, nga këto shkëmbime. **Bëjmë thirrje** për një qasje vërtet pan-evropiane ndaj programeve të shkëmbimit, nëpërmjet bashkëpunimit midis qeverive, OJQ-ve, donatorëve shumë-kombesh dhe të tjerë brenda dhe jashtë BE-së. Fermerët e rinj, profesionistët dhe të rinj të tjerë duhet të përfshihen si partnerë të barabartë në këto shkëmbime. Një kontribut kryesor në këtë proces duhet të bëhet nga Rrjeti Evropian për Zhvillimin Rural dhe Rrjetet Rurale Kombëtare të financuara nga BE në të gjitha vendet anëtare të BE-së.

29. Përkrahje dhe veprim

U kërkojmë rrjeteve të OJQ-ve evropiane të cilat iniciuan së bashku Parlamentin e Dytë dhe të Tretë Rural Evropian për të udhëhequr një program përkrahjeje dhe veprimi bazuar në këtë Manifest, duke punuar ngushtë me anëtarët e tyre kombëtarë dhe të gjithë partnerët e gatshëm për bashkëpunim.

30. Zotimi ynë

Ne zotojmë angazhimin tonë të vazhdueshëm në ndjekjen e vizionit dhe veprimeve të shprehura në këtë Manifest. Ne besojmë që komunitetet rurale, qeveritë dhe institucionet shumë-kombëshe, duke punuar së bashku, mund të arrijnë një rilindje të rajoneve rurale të Evropës.

Me këtë bindje, ne deklarojmë që:

E GJITHË

Evropa

duhet të ietojë!

Shënim shpjegues

Fushata e Parlamentit Rural Evropian 2015 – 2017 u ndërmor në bashkëpunim nga tre OJQ pan-evropiane: Aleanca e Komunitetit Rural Evropian, Partneriteti për Evropën Rurale PREPARE, dhe Shoqata Evropiane LEADER për Zhvillimin Rural.

Këtu u përshinë fushatat kombëtare për të mbledhur ide nga komunitetet rurale në 36 vende evropiane; konferenca kombëtare apo Parlamente Ruralë në shumë vende; dhe dy Parlamente Ruralë Evropianë tre ditore, ku morën pjesë palët e interesuara rurale nga 40 vende dhe nga qeveritë dhe institucionet ndërkombëtare. Manifesti do të formojë bazën për vazhdimin e fushatës nga tre trupat bashkë-iniciues dhe partnerët e tyre evropianë dhe kombëtarë.



*Under the auspices of
the Secretary General of
the Council of Europe,
Mr Thorbjørn Jagland*